



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në seancën e vazhduar të 51-të, të mbajtur më datë 01.09.2021 morri

VENDIM

Denoncimi me numër 12-5017 / 1 i datës 27.09.2019 i dorëzuar nga parashtrues i panjohur REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprim kompetent në lëndën me numër 12-5017 të vitit 2019.

Lënda me numër 12 -5017 e vitit 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim- në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12- 5017 të vitit 2019, e formuar sipas denoncimit me numër 12-5017/1 të datës 29.10.2019, e dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) nga parashtrues i panjohur, me të cilën denoncohet në mënyrë joligjore transporti i drunjëve.

Denoncimi i paraqitur i drejtohet gjithashtu shefit të ----- dhe -----, ku në të njëjtën janë nxjerrë pohime se me datë 22.10.2019 në orët e natës nga ana e policisë ----- - gjatë realizimit të kontrollit u kap personi- - ----- në mënyrë joligjore me kamion transportoi dru.

Ankuesit dyshojnë se drunjte dhe kamioni i personit të përmendur nuk ishin konfiskuar, për këtë arsye e denoncuan rastin në organet kompetente për të kontrolluar nëse policët e tyre të punësuar kanë ndërmarrë të gjitha veprimet zyrtare-ligjore apo jo. Gjithashtu kërkohet, nëse ata kanë vepruar në përputhje me rregulloret ligjore, atëherë të shqyrtohet nëse komandanti i policisë pyjore ----- dhe oficerët e policisë ----- dhe -----, të cilët ishin në vend ngjarje, kanë

ndërmarrë veprime në përputhje me ligjet e tyre dhe nëse ata nuk kanë marrë asgjë dhe kamioni me drunjtë, shefi dhe ministri të marrin të gjitha masat ligjore me qëllim ndalimin e krimit dhe parandalimin e korrupsionit në punën e shërbimit shtetërorë.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit të dorëzuar, KSHPK konstatoi se veprimet e denoncuara nuk janë në kompetencën e KSHPK -së për të vepruar, por janë në kompetencën e organeve të tjera në RMV-së, dhe të cilave parashtruesi tashmë i është drejtuar, pas së cilës vlerësoi se KSHPK nuk ka juridiksion për të vepruar në rastin në fjalë, rasti në fjalë të refuzohet dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHETËTOR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETAR
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:

- Arkivi
- Parashtruesi

Punoi: J.C.

Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së



